



Pranuar / Dorezuar / Punëhëno/Prodato Received / Delivered	08.09	2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	SIK/SIICK	6041/2023	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
				1/6



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.959/2023

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë; me Sabile Avdyli-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.930/2023, të datës 14.07.2023, të parashtruar nga ankuesja [redacted], nga Skenderaj, kundër Vendimit me numër protokoli 214, të datës 14.06.2023, të Komisionit të Vlerësimit të Lëvizjes Brenda Kategorisë në kuadër të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 08.09.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet** si e bazuar ankesa me numër A.nr.930/2023, e datës 14.07.2023, e parashtruar nga ankuesja [redacted].
- II. Anulohet** Vendimi me numër protokoli 214, i datës 14.06.2023, i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë, Konkursi me numër referencë RN00011238, për pozitën *Zyrtar i Lartë për Planifikimin e Zvogëlimit Rreziqeve*, i shpallur nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent, si dhe çdo veprim tjetër administrativ që rrjedhë nga kjo procedurë rekrutimi.
- III. Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja, [redacted] në datë 14.07.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.959/2023, kundër Vendimit me numër protokoli 214, të datës 14.06.2023, të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në kuadër

të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent, me pretendimet ankimore së gjatë zhvillimit të procedurës së konkursit me numër të reference RN00011238, për pozitën Zyrtar i lartë për planifikimin e zvogëlimit të rreziqeve, ka pasur shkëlqje procedurale dhe materiale, si dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë, në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, ndërsa, kjo e fundit, më datë 26.07.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me provat lidhur me këtë çështje juridike.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër protokollit 5835/23, të datës 28.08.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e parashtruar nga ankuesja me numër protokollit 5207/2023 të datës 14.07.2023, Kopja e konkursit me Nr.Reference: RN00011238; Njoftimin e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent për shpalljen e konkursit me numër reference RN00011238 të datës 29.03.2023; Njoftimin e datës 27.04.2023 të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent lidhur me kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit; Njoftimin e datës 05.05.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në AME; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm me numër protokollit 212 të datës 08.06.2023, Njoftimin e datës 16.06.2023, të Njesisë së Burimeve Njerëzore në AME; Diplomën me numër protokollit 3642 të datës 11.06.2017 të lëshuar nga SH.M "Hamëz Jashari"-Skenderaj për ankuesen; Diplomën me numër 1285 të datës 01.02.2015 të lëshuar nga Universiteti I Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës për V.K; Marrëveshjen për shërbime të veçanta lidhur mes Agjencisë së Menaxhimit Emergjent dhe ankueses; Marrëveshjen për shërbime të veçanta me numër protokollit 3 të datës 14.02.2019, lidhur mes Agjencisë së Menaxhimit Emergjent dhe ankueses; Akt emërimit të datës 03.06.2019 të ankueses, Kopjen e Letër njoftimit të ankueses; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil të datës 30.01.2023, të lëshuar nga Agjencia për Menaxhimin Emergjent për ankuesen; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike të lëshuar nga Agjencia për Menaxhimin Emergjent; Vendimin me numër 91/2019 të datës 08.11.2019 të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent; Vendimin me numër 113/2022 të datës 23.11.2022 të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Menaxhimin Emergjent; Vendimin me numër 03/2022 të datës 14.01.2022 të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Menaxhimin Emergjent; Ankesën e parashtruar nga ankuesja V.K me numër protokollit 213 të datës 13.06.2023 në Komisionin për Vlerësimin për Lëvizje Brenda kategorisë të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent; Vendimin me numër protokollit 214 të datës 14.06.2023 të Komisionit për Vlerësimin Brenda Kategorisë të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar I lartë për planifikim të zvogëlimit të rreziqeve në Agjencinë për Menaxhimin Emergjent; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 20.07.2023 të Këshillit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 219 të datës 26.07.2023 të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent për Këshillin bashkë me shkresat e lëndës; Vendimin me numër 62/2023 të datës 26.05.2023 të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent lidhur me Themelimin e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë; Lista e kandidatëve të aprovuar dhe të refuzuar për Konkursin me numër reference RN00011238 për pozitën Zyrtar i lartë për planifikimin e zvogëlimit të rreziqeve; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 07.06.2023 të konkursit me numër reference RN00011238 për pozitën Zyrtar i lartë për planifikimin e zvogëlimit rreziqeve; E-mailin e datës 08.06.2023 të dërguar nga V.G për V.K; E-mailin e datës 15.06.2023 të dërguar nga V.G për V.K; Ankesa me nr .protokollit 213 të datës 13.06.2023 e parashtruar nga ankuesja për Komisionit e Vlerësimit për Lëvizje brenda kategorisë; Aplikacionin e kandidatit A.P të datës 13.04.2023 ; Diplomën me numër 853 të datës 20.02.2012 të lëshuar nga Universiteti I

Prishtinës-Fakulteti I Shkencave Matematike-Natyrore për A.P; Diplomën me numër protokoll 4/289/119 të lëshuar nga Gjimnazi " Xhevdet Doda"- Prishtinë për A.P; Vendimin e datës 14.09.2015 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës për A.P; Vendimin e datës 23.11.2006 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës për A.P; Vërtetimin e punësimit të datës 12.06.2007 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës për A.P; Letër falënderimi të datës 31.07.2017 të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Kosovës në Prishtinë për A.P; Letër rekomandimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës për A.P; Kopje e Letërnjoftimit të A.P; Letër reference me numër protokoll 1081/2022 të datës 15.08.2022 të SH.F.M.U "Andon Zako Çajupi"-Bardhosh për A.P; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues I mesëm, I ulët dhe profesional të datës 17.01.2022 të Policisë së Kosovës për A.P; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional të datës 17.01.2022 të Policisë së Kosovës për A.P; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional të datës 30.01.2022 të Policisë së Kosovës për A.P; Vërtetimin e datës 13.04.2023 të Policisë së Kosovës për A.P; Vërtetimin e datës 13.04.2023 të Policisë së Kosovës për A.P; Aplikacionin e kandidatës 20.04.2023 të V.K së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Dëftesën me numër protokoll 697 të datës 08.06.2005 të SH.F "Ramiz Sadiku"-Skenderaj për V.K; Dëftesën me numër protokoll 1316 të datës 12.06.2006 të SH.M "Hamëz Jashari"-Skenderaj për V.K; Dëftesën me numër protokoll 1982 të datës 21.05.2007 të SH.M "Hamëz Jashari"-Skenderaj për V.K; Certifikatën e datës 17-18-23-2018 të Institutit të Kosovës për Administratë Publike për V.K; Certifikatën me numër 168 të datës 17.06.2018 të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave për V.K; Vendimin për pushim të lehonisë me numër 33 të Agjencisë së Menaxhimit të Emergjent; Vërtetimin me numër 197 të datës 13.04.2023 të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent; Vërtetimin me numër protokoll 196 të datës 13.04.2023 të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent; E-maili zyrtar i datës 29.08.2023 nga Menaxheri i Personelit në AME dhe E-maili zyrtar i datës 29.08.2023 nga Menaxheri i Personelit në AME.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankueses, *sepse*:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Agjencia për Menaxhimin Emergjent, më datë 29.03.2023, ka shpallur në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), Konkursin për Lëvizje Brenda Kategorisë, me numër reference RN00011238, për pozitën e punës "Zyrtar i lartë për planifikimin e zvogëlimit rreziqeve", në Divizionin e Zvogëlimit të Rreziqeve dhe Hetimit të Shkaqeve të Zjarrit, Klasa "profesional 1", numri i kërkuar një (1) pozitë.

Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 13.04.2023 deri me datën 20.04.2023, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, duke u përfshirë në të gjitha fazat e vlerësimit.

Sipas renditjes përfundimtare të kandidateve të datës 07.06.2023, kandidati . është vlerësuar si kandidati me më shumë pikë, gjithsej 67 pikë, ndërsa, ankuesja është vlerësuar më gjithsej 65.8 pikë, duke u renditur si kandidati i dytë. Mbi këtë vlerësim të Komisionit të Vlerësimit, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të AME-së, me datë 08.06.2023 ka shpallur njoftimin lidhur me kandidatin e suksesshëm.

Ankuesja e pakënaqur me njoftimin e datës 08.06.2023 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të AME-së, me datë 12.06.2023, ka parashtruar ankesë pranë Komisionit për Vlerësim Brenda Kategorisë ( tutje vetëm Komisioni i Vlerësimit), ndërsa ky i fundit me Vendimin me numër protokoll 214, të datës 14.06.2023, ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar.

Ankuesja brenda afatit ligjor ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar Vendimin me numër protokoll 214, të datës 14.06.2023, të Komisionit të Vlerësimit, për shkak të shkeljeve procedurale dhe materiale si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Shton se kandidati i përzgjedhur nuk ka plotësuar kriteret e konkursit pasi që i njëjti nuk ka kualifikimin arsimor të kërkuar dhe përvojën e punës në fushën në të cilën zhvillohet procedura.

Në kontekst të pretendimeve ankimore Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë përkitazi me procedurën e lëvizjes brenda kategorisë, gjegjësisht Kolegji analizoj nenin 38 me të cilin është përcaktuar se: *"1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni...:5. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga një komision vlerësimi, i krijuar në çdo institucion, bazuar në një intervistë me kandidatët. Komision përbëhet nga pesë anëtarë, njëri nga të cilët është domosdo përfaqësues i Njësisë së Burimeve Njerëzore të institucionit. 6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm për t'u emëruar në vendin e lirë, apo; 6.2. përfundimin e procedurës, pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk vlerësohet i suksesshëm për atë vend të lirë të punës."*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit mori për bazë edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht:

Nenin 44 paragrafit 1 dhe 2, më të cilin është përcaktuar se: *"1. Konkurimi për lëvizjen brenda kategorisë zhvillohet në dy faza: 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. vlerësimi i kandidatëve. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ, ndërsa vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, krijuar sipas nenit 47 të kësaj Rregulloreje"*

Nenin 45 paragrafit 1, 2 dhe 3, me të cilin është përcaktuar se: *"1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lire. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin"*.

Nenin 47 paragrafin 1, 2, 3 dhe 4, me të cilin përcaktohet se: *"1. KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2. Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurimi. 3. KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës.. 4. Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pike"*.

Nenin 48 paragrafin 1 dhe 2, me të cilin përcaktohet se: *"...Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mblidhen dhe pjesëtohen me pesë. 2. Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mblidhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësimin përfundimtar të konkurimit"*.

Nenin 49 paragrafin 1, 2 dhe 3, me të cilin përcaktohet se: *"1. KVLB në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njësisë Përgjegjëse brenda njëzetë e katër (24) orëve nga miratimi i saj. 2. Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi. 3. Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues"*.

Andaj, në kuptim të kuadrit ligjor si me sipër, si dhe në mbështetje të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji ka analizuar ligjshmërinë e veprime procedurale që përbejnë tërësinë e procesit të rekrutimit sipas Konkursit me numër reference RN00011238, rrejdhimisht Kolegji nga analizimi i aktit të shpalljes së konkursit ka konstatuar së për pozitën “Zyrtar i lartë për planifikimin e zvogëlimit rreziqeve” si kualifikime të posaçme formale janë përcaktuar : *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve në shkencat natyrore, teknike. Përvoja e punës së kërkuar: Se paku dy (2) vite përvoja pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës*, kështu që, në vlerësimin e Kolegjit kriteri i arsimit sipas konkursit në fjalë nuk është në pajtim me dispozitat e Rregullores QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 18 të kësaj rregullore më të cilin përcaktohet se: *Kërkesat e përgjithshme formale janë kërkesat për zotërimin e arsimit që përfshin nivelin dhe fushën e arsimit, kualifikimin apo certifikimin e posaçëm që kërkohet për atë pozitë përkatëse (psh. provimin e jurisprudencës apo ndonjë certifikim tjetër), përvojës profesionale domethënëse në profesion dhe/apo në punë apo kushteve të tjera specifike (psh. zotërimi një certifikimi për një gjuhë të huaj, etj.), përkatësisht në konkursin me numër referencë RN00011238, është përcaktuar lloji i shkencave arsimore ashtu që citohet: “shkencat natyrore-teknike”, pa specifikuar saktë fushat e arsimit që kërkohen për pozitën e shpallur. Ndërlidhur me këtë, Kolegji po nga shkresat e lëndës nuk vëren së organi i punësimit, ka bërë kualifikimin dhe ka miratuar përshkrimin detyrave të punës për pozitën Zyrtar i lartë për planifikimin e zvogëlimit rreziqeve, në Divizionin e Zvogëlimit të Rreziqeve dhe Hetimit të Shkaqeve të Zjarrit, ashtu siç është kërkuar me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.*

Përkundër konstatimit si me sipër, Kolegji i Këshillit nga analizimi i dokumentacionit të aplikimit, ka gjetur së kandidati [REDAKTUAR], i renditur si kandidati me i suksesshëm në Konkursin me numër reference RN00011238, lidhur me kriterin e arsimit posedon diplomën më numër 853 të datës 20.02.2012, të lëshuar nga Fakulteti i Shkencave Matematikë-Natyrore, sipas të cilës vërtetohet së i njëjti me datë 27.12.2011, ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, Departamenti i Gjeografisë, duke marr titullin Bachelor i Gjeografisë-Përgjithshëm, kurse, lidhur me kriterin e përvojës së punës posedon Vërtetimin me numër reference 07/1-01SAP-P/44595, të lëshuar nga Sektori i Administratës dhe Personelit të Policisë së Kosovës, sipas të cilat rrjedhë së është i punësuar si staf civil, në Policinë Kosovës dhe si njëjti që nga data 01.08.2005, ushtron pozitën e punës Zyrtar i Bazës së të Dhënave, kurse sipas letër referencës të datës 15.08.2022 me Nr.prot.1081/2022, prej datës 01.04.2004 deri më datë 30.09.2004, ka qenë mësimitdhënës i lëndës së gjeografisë në SHFMU “Andon Zako Çajupi” në fshatin Bardhosh. Sipas dokumentacionit të aplikimit të ankueses, konstatohet se e njëjta lidhur me kriterin e arsimit posedon Diplomën me numër 1285, të datës 01.02.2016, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, për përfundimin e studimeve në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Departamenti i Ndërtimtarisë, duke marr titullin Bachelor i Ndërtimtarisë, kurse lidhur me përvojën e punës posedon dëshmi së nga data 12.11.2018 deri 12.08.2019 dhe nga data 13.02.2019 deri 13.05.2019, ka punuar sipas marrëveshjeve për shërbime të veçanta në Agjencinë për Menaxhimin Emergjent si Zyrtar për aplikimin e masave parandaluese, kurse, nga data 03.06.2019 e njëjta është emëruar dhe vazhdon të ushtroj pozitën e nëpunësit civil me titull “ Zyrtar i Lartë për hulumtimin e shkaqeve të zjarrit”. Andaj, nisur nga këto fakte, Kolegji konstaton së kandidati [REDAKTUAR], i shpallur si kandidat i suksesshëm nuk ka plotësuar kriterin e përvojës së punës pasi që i njëjti nuk ka dy (2) vite përvoja pune profesionale në fushën apo të ngjashme me fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë, dhe si rrjedhojë pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara.

Siç u tha me sipër, dhe duke qenë se procedura lidhur me Konkursin për Lëvizje Brenda Kategorisë, me numër reference RN00011238, për pozitën “Zyrtar i lartë për planifikimin e zvogëlimit rreziqeve”, në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, është përcjell me shkelje ligjore të specifikuar si me lart, Kolegji në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton së një procedurë e përcjell me shkelje procedurale dhe materiale konsiderohet si e paligjshme, kështu që mbi këtë bazë, Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


**Këshillë juridike:** Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.959/2023

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse



Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit



#### Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm i Agjencisë të Menaxhimit Emergjent;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

